



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:230758
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05632512

C.nr.2501/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.A. nga Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Musa Haxhiu nga Vitomerica Rajoni 3 Komuna Pejë, kundër të paditurit O.I., nga fshati I., Komuna e Deçanit, baza juridike për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri – banesës mbi bazën juridike të shitblerjes dhe posedimit, vlera e kontestit 5000 euro, jashtë seance me datën 29.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje kontestimore C.nr.2501/21, për shkak të vdekjes së të paditurit O.I., nga fshati I., Komuna e Deçanit.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit (të ndjerit) e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi K.A. nga Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 14.10.2021 ka parashtruar padi ndaj këtu të O.I., nga fshati I., Komuna e Deçanit, me bazë juridike për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri – banesës mbi bazën juridike të shitblerjes dhe posedimit, vlera e kontestit 5000 euro.

Gjykata sipas dispozitave ligjore të LPK, me të pranuar padinë dhe provat e bashkangjitura, i ka dërguar palës së paditurit, aktvendimin për përgjigje në padinë se bashku me provat e bashkangjitura, por që i padituri nga fletëkthesa kthyer gjykatës konstatohet se i padituri ka ndërruar vendbanimin.

Gjykata, në mënyrë të që të vërtetoj saktësisht se këtu i padituri ku gjendet me vendbanim dhe ndonjë informacion të saktë lidhur me adresën e të paditurit, ka nxjerr aktvendimin C.nr.2501/21, i datës 14.03.2024, me të cilin aktvendim e ka kthyer në plotësim padinë e

paditësit ashtu që i njëjti të siguroj adresën 3e sakte dhe të fundit të palës së padituri. Gjykata me datën 20.03.2024, ka pranuar përgjigje nga pala paditëse, duke dhënë adresën e njëjtë për të paditurin në fjalë. Gjykata po ashtu i është drejtuar Administratës Komunale – zyrës për regjistrimin e gjendjes civile të Komunës së Deçanit, me kërkesën e datës 18.03.2024, sipas të cilës kërkesë zyra për regjistrimin e gjendjes civile të Komunës së Deçanit ka njoftuar se i padituri ka vdekur në R. Komuna e Pejës, me datën 18.07.2015, ku i është bashkëngjitur certifikata e vdekjes me numër serik. V10674138 e datës 12.04.2024.

Prandaj, gjykata pas vlerësimit të kësaj situatë, nxjerr përfundim se janë plotësuar kushte ligjore që të bëhet ndërprerja e procedurës në këtë kontest në kuptim të dispozitës së nenit 277 par. 1 pika a) të LPK-së, për shkak të vdekjes së të paditurit, sipas të cilit nen përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose humb gjyqësinë procedurale”*, i ndryshuar me nenin 18 të Ligji nr. 04/L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore.

Ndërsa me dispozitën e nenit 280 të LPK-së, thuhet se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjore, administratori i falimentimit apo paraardhësi juridik i personit juridik, merr përsipër procedurën apo kur i thirret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Ndërsa me dispozitën e nenit, 329 par 1 të LPK-së, është përcaktuar shprehimisht: *“Fuqia provuese e shkresave, shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. 329.2 të LPK-së, të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike”*.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142, 277 pika (a) dhe nenit 387 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2501/21, me datë 29.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.